



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR SHYRTIMIN E KËRKESËS SË Z. GJERGJI PRFTI, PËR REGJISTRIMIN E LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKISË TË PARTISË LISTA E BARABARTË TË DEPOZITUARA PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 17.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për shyrtrimin e kërkesës së partisë Lista e Barabartë për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Durrës, Tiranë, Elbasan për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", neni 67, pika 2, neni 165, pika 3 neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia "Lista e Barabartë" si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**V Ë R E N:**

Partia "Lista e Barabartë" me vendimin e KQZ-së nr.204, datë 23.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019.



**Nr. 463 i Vendimit**

**Data 17.05.2019**

**Ora 12:00 e Vendimit**

Për shyrtrimin e kërkesës së partisë Lista e Barabartë për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Durrës, Tiranë, Elbasan për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Z. Gjergji Prifti me cilësinë e kryetarit të partisë, ka depozituar në KQZ kërkesën për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve të për anëtar Këshilli në bashkitë: Tiranë, Durrës, Elbasan,

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetar apo për këshillin e bashkisë, pasi bashkitë : Tiranë, Durrës, Elbasan, administrohen nga më shumë se një KZAZ.

Referuar vendimit të KQZ-së nr. 204, datë 23.04.2019, Partia "Lista e Barabartë" është regjistruar si subjekt zgjedhor, me Kryetar z. Ben Blushi. Bazuar në nenin 67, pika 2 dhe neni 72, pika 2, germa dhe pika 3, të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore, kërkesa për regjistrimin duhet të nënshkruhet nga kryetari i partisë edhe nga një person i autorizuar nga kryetari i partisë.

Lista e kandidatëve për anëtar Këshilli në bashkitë: Tiranë, Durrës, Elbasa janë nënshkruar nga z. Gjergji Prifti i cili nuk është i autorizuar nga Kryetari i Partisë Lista e Barabartë z. Ben Blushi.

Në këto kushte, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nga verifikimi i dokumentacionit konstaton se kërkesat e paraqitura nga z. Gjergji Prifti janë në kundërshtim me pikën 2, gërma a, pikën 3 të nenit 72 të Kodit Zgjedhor.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa a, nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

#### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e kërkesës Z. Gjergji Prifti për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtar Këshilli në bashkitë: Tiranë, Durrës, Elbasan, të Partisë Lista e Barabartë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 463 i Vendimit**

**Data 17.05.2019**

**Ora 12:00 e Vendimit**

Për shyrtimin e kërkesës së partisë Lista e Barabartë për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Durrës, Tiranë, Elbasan për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019